

VENDIM
Nr. 107, datë 26.6.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 83, DATË 31.5.2019,
MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SANG 1” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “THIRRË” ME KAPACITET
TË INSTALUAR 1.820 mw**

(Ndryshuar me vendimin nr. 65, datë 4.3.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative” nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 26.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin plotësues me nr.51/10-1, datë 20.6.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Në mbledhjen e Bordit të ERE-s të datës 31.5.2019, shoqëria “SANG 1” sh.p.k me vendimin nr. 83, u licencua në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë”.

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124 prot., datë 6.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim edhe në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

- Në mbledhjen e bordit të ERE-s të datës 31.5.2019 u kërkuar që të sqarohet me shoqërinë “SANG 1” sh.p.k., në një seancë dëgjimore, vlera financiare e vënë në dispozicion për secilën veprimtari, pasi ajo e deklaruar nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k., nuk rezulton e mjaftueshme për të dy veprimtaritë.

- Për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike përfaqësuesit e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., deklaruan në seancë se do të dërgojnë në ERE një kontratë sipërmarrje e cila justifikon çdo investim dhe vlerat monetare të vëna në dispozicion të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- Kontrata e sipërmarrjes, datë 29.4.2019, “Për punime civile dhe ndërtimin e HEC “Thirrë”, e lidhur midis shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në cilësinë e investitorit për realizimin e projektit të ndërtimit të HEC “Thirrë” dhe shoqërisë “Xhast” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, për realizimin në sasi dhe cilësi të punimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi (e depozituar në ERE nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124/10, datë 11.6.2019), nuk përbën dokumentacion që vërteton aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin, por përbën një detyrim financiar për t’u përmbushur nga ana e shoqërisë, nëpërmjet mjeteve financiare që ka në dispozicion.

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k, nuk ka depozituar në ERE asnjë dokumentacion, që vërteton mbështetjen financiare të shoqërisë për shlyerjen e kësaj kontrate dhe vijimin e investimit për ndërtimin e veprës prodhuese. Nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k në seancën dëgjimore të datës 05.06.2019, u deklarua se deklaruar shuma e vendosur si mbështetje financiare për të dy aktivitetet, vihet në dispozicion të veprimtarisë së tregëtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 83, datë 31.5.2019, ndryshon dhe bëhet:

Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., të depozitojë në ERE:

2.1 Lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor nr. 97 prot., datë 8.5.2017, përpara datës 27.4.2022.

2.2 *Shfuqizuar.*

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti